HK – HEKURUDHAT E KOSOVËS
MŽ – MAKEDONSKE ŽEKEZNICE

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 99
Dt. 15-02-2016
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 92
Dt. 15-02-2016
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

МАКЕДОНСКИ ЖЕЛЕЗНИЦИ
ТРАНСПОРТ АД - СКОПЈЕ
Бр. 367/1
22. 02. 2016 год.
СКОПЈЕ

Јавно претпријатие за железничка инфраструктура
МАКЕДОНСКИ ЖЕЛЕЗНИЦИ
Бр. 851
20 год.
Скопје
22-02-2016

MARRËVESHJE

ZBATUESE PËR NDËRLIDHJE TË RRJETEVE HEKURUDHORE NDËRMJET HEKURUDHAVE TË KOSOVË (HK) DHE HEKURUDHAVE MAQEDONASE (MŽ)

SHKURT 2016

Në bazë të nenit 14 të Marrëveshjes mbi rregullimin e komunikacionit hekurudhor kufitar (në tekstin e mëtejmë "Marrëveshja"), e nënshkruar në Shkup me datën 15.09.2011 ndërmjet qeverive të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës; Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA "Infrakos" dhe Operimi me Trena në Hekurudhat e Kosovës ShA "Trainkos" (në tekstin e mëtejmë HK-Hekurudhat e Kosovës) në njërën anë dhe JPM Infrastruktura dhe MŽ Transport AD - Skopje në tekstin e mëtejmë (MŽ-Hekurudhat Maqedonase) në anën tjetër, janë pajtuar me sa vijon:

MARRËVESHJA ZBATUESE
Për ndërlidhej të rrjetit hekurudhorë ndërmjet HK dhe HM

Dispozitat e përgjithshme
Neni 1

Lëndë e kësaj marrëveshjeje janë aktivitetet të cilat do t'i ndërmarrin palët e marrëveshjes lidhur me rregullimin e komunikacionit hekurudhor ndërmjet të (MŽ) dhe (HK) mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave në zonën kufitare hekurudhore

Përdorimi i termave
Neni 2

Termet e përdorura në këtë marrëveshje kanë këto kuptime:

1. **Marrëveshja** – Nënkupton Marrëveshja mbi Kalimin Kufitar e nënshkruar në Shkup me datën 15.09.2011 ndërmjet qeverive të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës
2. **Hekurudha amë** – nënkupton hekurudhën e cila i përket palës vendore;
3. **Hekurudha fqinje** - nënkupton hekurudhën e cila i përket palës fqinje;
4. **Stacioni kufitar**- nënkupton stacionet hekurudhore të palëve të marrëveshjes afër kufirit të cilat i takojnë zonës hekurudhore;
5. **Hekurudha kufitare** – nënkupton hekurudhën në mes të stacioneve kufitare;
6. **Stacioni i ndërrimit të komunikacionit**- nënkupton stacionin e përbashkët kufitar brenda zonës hekurudhore në të cilin kryhen veprimet e përbashkëta të ndërrimit të komunikacionit;
7. **Linja kufitare** – nënkupton linjën kufitare ndërmjet dy rrjeteve hekurudhore të infrastrukturës të palëve të marrëveshjes;
8. **Seksioni kufitar** – nënkupton pjesën e rrjetit hekurudhor ndërmjet stacionit hekurudhor kufitar dhe linjës kufitare të palëve të marrëveshjes;
9. **Ndërrimi i komunikacionit**- nënkupton mënyrën dhe veprimet rreth pranim-dorëzimit të trenave, vagonëve dhe dërgesat të mallra ndërmjet të dy hekurudhave i cili bëhet në zonën hekurudhore;

10. **Kontrollimi kufitar** – nënkupton veprimet e caktuara të përbashkëta sipas dispozitave të brendshme të cilat kanë të bëjnë me hyrje, daljet dhe transitin e udhëtarëve dhe dërgesave të mallrave;

11. **Personeli zyrtar**- nënkupton personelin e përgjithshëm i cili merr pjesë në kryerjen e komunikacionit hekurudhor kufitar ku bëjnë pjesë:

    - Personeli hekurudhor, dhe
    - Personeli i autorizuar i organeve kompetente (dogana, policia dhe inspekcionet përkatëse);

12. **Dërgesat zyrtare** – nënkupton letrat zyrtare, formularët zyrtar, orarin e lëvizjes, tarifat, si dhe dërgesat me vlerë monetare të destinuara për njësitë zyrtare të hekurudhës fqinje;

13. **Dërgesa** – nënkupton një ose më shumë mallra të cilat transportohen me hekurudhë me një dokument;

14. **Prerja tarifore** - nënkupton pikën e dakorduar në linjën hekurudhore kufitare deri te e cila hekurudhat fqinje kanë të drejt në të ardhura nga transporti i përbashkët i udhëtarëve dhe mallrave;

15. **Përfaqësia** – nënkupton shërbimin me një ose më shumë të punësuar në stacionin e ndërrimit të komunikacionit ose në stacionin kufitar të cilët kryejnë punë për nevoja të hekurudhës së vet në territorin e hekurudhës fqinje;

16. **Zona hekurudhore** – nënkupton territorin e shtetit amë në të cilin personeli zyrtar i shtetit fqinjë është i autorizuar të kryej komunikacionin hekurudhor sipas nenit 3 të Marrëveshjes.

Stacionet kufitare dhe stacioni i ndërrimit të komunikacionit
Neni 3

1. Komunikacioni hekurudhor kufitar për transportimin e udhëtarëve dhe dërgesave të mallrave ndërmjet të MŽ dhe HK do të realizohet në seksionin kufitar Vollkovë - Hani i Elezit.

2. Stacionet kufitare janë:

    - Në MŽ - stacioni Vollkovë,
    - Në HK- stacioni Hani i Elezit.

3. Stacioni i ndërrimit të komunikacionit është stacioni Hani i Elezit për komunikacion të udhëtarëve dhe të mallrave.

4. Prerja tarifore në linjën kufitare Vollkovë - Hani Elezit gjendet në km 313+510

5. Distanca e stacioneve kufitare përcaktohet nga prerja tarifore:

    - Vollkovë – prerja kufitare është 11.718 km
    - Hani Elezit – prerja kufitare – është 1.910 km

Pajisjet, stabilimentet dhe lokalet zyrtare
Neni 4

1. Hekurudha amë i siguron hekurudhës fqinje pajisjet, stabilimentet, lokalet dhe mjetet e ndërlidhjeve në stacionin e ndërrimit të komunikacionit të cilat janë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve, si dhe lokalet për pushim të personelit zyrtar.

2. Për pajisjet, stabilimentet dhe lokalet. nga paragrafi 1 i këtij neni të cilat i janë siguruar hekurudhës fqinje, dhe të cilat ajo i shfrytëzon, hekurudha amë ia faturon pagesën hekurudhës fqinje sipas Marrëveshjes së veçantë.

3. Për komunikim ndërmjet stacioneve kufitare secila hekurudhë në territorin e vet i siguron mjetet e nevojshme të ndërlidhjeve. Ato mjete të ndërlidhjeve, personeli i hekurudhës fqinje do t'i shfrytëzon pa pagesë. Për pajisjet të cilat shfrytëzohen për komunikim në rrjetin publik, shpenzimet i bartin secili shfrytëzues për veti.

4. Kufiri i mirëmbajtjes dhe i mbikëqyrjes së linjës hekurudhore, në parim nënkuptohet prerja e shinave e cila është më e afërt prerjes tarifore. Te sinjalet siguruese dhe pajisjeve të telekomunikimit, kufiri i mirëmbajtjes dhe i mbikëqyrjes është pika testuese e cila është e caktuar ose e ndërtuar për këtë qëllim. Përjashtim bëjnë stabilimentet e jashtme ose të brendshme dhe objektet e telekomunikimit dhe pajisjet e sinjaleve, përkatësisht të linjave ajrore ose të kabllove nëntokësor dhe stabilimentet përcjellëse të tyre, si dhe objektet të cilat shërbejnë për siguri të lëvizjes së trenave të cilat në rast të nevojës sipas rregullave teknike vendosen në territorin e shtetit fqinjë.

Si kufi i mirëmbajtjes dhe mbikëqyrjes caktohet objekti ose vendi për të cilin palët e marrëveshjes janë pajtuar duke e marr parasysh rëndësinë e objekteve të linjës hekurudhore.

Dispozitat më të detajuara për mirëmbajtje të pajisjeve dhe stabilimenteve do të parashkruhen me dispozitat e përbashkëta zyrtare.

5. Çdo modernizim dhe ndryshim të ndërlidhjeve dhe pajisjeve sinjalo siguruese do të kryhet në bazë të marrëveshjeve të posaçme ndërmjet të dy hekurudhave. Gjithashtu hekurudhat ndërmjet veti do të informohen për ndërtimin e ri ose rekonstruktimin dhe zgjerimin e objekteve në territorin e vet të cilat shërbejnë për zhvillimin e komunikacionit kufitar.

Shpenzimet e këtyre ndryshimeve në objekte dhe pajisjet do ti bart hekurudha të cilës i përkasin ato.

Përfaqësia në stacionet e ndërrimit të komunikacionit, përkatësisht në stacionet kufitare
Neni 5

1. Hekurudha fqinje mundet që në stacionin për ndërrimin e komunikacionit, përkatësisht në stacionin kufitar të hapë përfaqësinë e vet me qëllim të mbrojtjes të interesave të hekurudhave të veta. Hekurudha amë me këtë duhet të pajtohet. Shpenzimet e përfaqësisë i bart hekurudha fqinje.

2. Përfaqësia organizon dhe kryen mbikëqyrjen e personelit. Përfaqësia mbron interesat e hekurudhës së vet në të gjitha punët zyrtare të cilat së bashku i kryejnë të dy hekurudhat ose kur hekurudha amë i kryen ato punë për të dy hekurudhat.

Gjatë kohës së kryerjes së shërbimit përfaqësisë duhet ti mundësohet shikueshmëri në shënime zyrtare të cilat hekurudha amë i kryen për hekurudhat fqinje ose për të dy hekurudhat.

Përfaqësia ka të drejt që të bënë përshkrimin ose ekstraktin të atyre shënimeve zyrtare.

3. Përfaqësia është e autorizuar në marrëveshje me shefin e stacionit, drejtpërsëdrejti t'i komenton ose të merr pjesë në hetuesinë e ngjarjeve të jashtëzakonshme të cilat kanë ndodhur , dhe për parregullsitë e vërejtura dhe të pakoordinuara.

4. Përfaqësia nuk është e autorizuar t'i jep asnjë urdhëresë personelit të hekurudhave amë, dhe as të ndërhyn në kryerjen e punëve të tyre.

5. Shkresat zyrtare të dërguara hekurudhës fqinje dhe të pranuara në stacionin e ndërrimit të komunikacionit ose në përfaqësi, dorëzohen bashkërisht.

6. Përfaqësia e hekurudhave fqinje ka të drejt që lokalet zyrtare të ndara në territorin e hekurudhave amë t'i shënon me shenjën dhe mbishkrimin e hekurudhave të veta. Mbishkrimi mbi lokale- zyrave shkruhet me shkrim zyrtar, ashtu që në rend të parë shënohet mbishkrimi i hekurudhave fqinje.

Rregullimi në lidhje me këtë pikë duhet t'i përshtatet gjendjes së përgjithshme të objektit të stacionit, për të cilën pajtohen përfaqësia me shefin e stacionit.

7. Numri i punëtorëve të hekurudhave fqinje të cilët kryejnë shërbimin në stacionin e ndërrimit të komunikacionit caktohet me marrëveshje, njëherë në vit dhe mund të ndryshohet sipas nevojës.

8. Gjatë kryerjes së punëve në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, paraprakisht në stacionet kufitare, personeli i hekurudhave fqinje mund të lëvizë dhe të qëndron në territor të stacionit dhe në lokalet zyrtare të domosdoshme për kryerjen e punëve.

Rendi dhe siguria në seksionin hekurudhor kufitar
Neni 6

1. Organet përkatëse në secilën anë të kufirit janë të obliguara për sigurim të rendit dhe sigurisë në seksionin hekurudhor kufitar.

2. Gjatë kohës së kryerjes së punëve në trena të cilët lëvizin në seksionin kufitar , personeli i hekurudhave fqinje, në rast të rrezikimit të rendit dhe sigurisë në komunikacionin hekurudhor doemos duhet ta informojnë stacionin kompetent të hekurudhave amë.

Gjuha punuese
Neni 7

1. Gjuhët punuese për komunikim me personelin zyrtar të hekurudhave fqinje në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, përkatësisht në stacionet kufitare dhe seksionin kufitar janë: Gjuha Shqipe, Maqedonase , Serbe dhe Angleze.

2. Komunikimet telefonike, informatat e shkruara dhe gojore që kanë të bëjnë me lëvizjen e trenave, duhet të udhëhiqen në njërën nga gjuhët e cekura të punës.

3. Personeli zyrtar i të dyja hekurudhave duhet t'i njohë gjuhët e lartcekura.

Pozita juridike e personelit hekurudhor
Neni 8

1. Personeli hekurudhor i cili kryen shërbim në lidhje me këtë marrëveshje në anën tjetër të kufirit i nënshtrohet normave juridike të asaj gjykate përkatëse.

2. Personeli hekurudhor i cili kryen shërbim në anën tjetër të kufirit, duhet të sillet në harmoni të fqinjësisë së mirë të marrëdhënieve të dy hekurudhave, si në kohë të shërbimit ashtu dhe jashtë saj.

3. Personeli zyrtar i hekurudhës amë është i obliguar që personelit të hekurudhës fqinje t'i ofron ndihmën e nevojshme dhe mbrojtjen gjatë kryerjes të detyrës së tyre zyrtare.

4. MŽ dhe HK i ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje të plot juridike zyrtarëve të vetë në territorin e hekurudhës fqinje.

5. MŽ dhe HK janë të obliguara që të informohen ndërmjet veti për veprimet ndëshkuese të cilat personeli zyrtar i hekurudhave fqinje i ka kryer në territor të hekurudhave amë.

6. Shërbimi përkatës i hekurudhave fqinje është i obliguar që në kërkesë të shërbimit përkatës të hekurudhave amë menjëherë ta revokoj zyrtarin e vetë. Kërkesa për revokim nuk ka nevojë për arsyetim.

Ndihma mjekësore
Neni 9

Personelit hekurudhor të hekurudhave fqinje, në rast të sëmundjes ose lëndimit në zonën hekurudhore, në stacionin kufitar dhe në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, respektivisht edhe më larg nga stacioni, në rastet e parapara në nenin 3 të kësaj marrëveshje, ose gjatë kohës së ofrimit të ndihmës me shërbime të tërheqjes, hekurudha amë pa pagesë i ofron ndihmën e parë të nevojshme.

Kalimi i kufirit dhe qëndrimi në anën tjetër të kufirit.
Neni 10

1. Personeli hekurudhor, duke e përfshirë edhe personelin mbikëqyrës, gjithashtu edhe personelin i cili merr pjesë në hetuesinë dhe eliminimin e pasojave të ngjarjes së jashtëzakonshme, duhet të ketë fletë lëshimin zyrtar për kalim të kufirit ose të jetë evidentuar në regjistrin e personave të cilët e kalojnë kufirin për nevoja zyrtare, në harmoni me nenin 10 të Marrëveshjes.

2. Punëtorët për mirëmbajtjen e linjës hekurudhore, pajisjeve SS dhe TK për eliminim të pengesave dhe kontrollin e pajisjeve, mund të kalojnë kufirin edhe në këmbë nëpër binar. Për këtë lloj të kalimit të kufirit, paraprakisht duhet të informohen organet doganore, Policia kufitare dhe të paralajmërohen edhe organet fqinje, dhe tek pasi që të merret pëlqimi nga ato organe mund të kalohet kufiri shtetëror.

3. Punëtorët e hekurudhës fqinje, pas kalimit të kufirit dhe arritjes në stacionin kufitar të hekurudhës fqinje, duhet që menjëherë ta lajmërojnë drejtuesin e trenave kujdestar për arritjen e tyre. Gjithashtu, para nisjes duhet ta lajmërojnë drejtuesin e trenave kujdestar në stacionin në të cilin kanë kryer shërbimin.

4. Punëtorët e MŽ dhe HK, gjatë kryerjes së detyrave të punës në stacionet kufitare, stacionet e ndërrimit të komunikacionit ose në seksionet kufitare të hekurudhave fqinje, nuk guxojnë të lëshojnë dalin jashtë territorit të stacionit dhe seksionit hekurudhor në të cilin kanë kryer punë.

Uniforma zyrtare dhe armatimi
Neni 11

1. Personeli hekurudhor i cili kryen shërbim në territorin e hekurudhës tjetër duhet të bart uniformen ose shenjat zyrtare të dukshme të hekurudhës së vet në kohën e shërbimit dhe në kohën e ardhjes dhe vajtjes nga puna.

2. Personeli hekurudhor nuk guxon të mbaj armë gjatë kohës të kryerjes së shërbimit.

Lehtësirat doganore për gjësendet për përdorim vetanak për personel hekurudhor dhe gjësendet e dedikuar për përdorim të shërbimit hekurudhor
Neni 12

1. Të gjitha gjësendet të dedikuara për përdorim vetanak dhe për shërbim, të cilat personeli hekurudhor i hekurudhave fqinje gjatë kryerjes se punëve dhe detyrave të punës i bartin ose qesin jashtë kufirit , janë të liruara nga pagesa doganore dhe taksat tjera.

2. Gjësendet e dedikuara për shërbimin hekurudhor, materiali dhe pjesët rezervë të nevojshme për riparimin dhe mirëmbajtjen të parkut të vetë lëvizës, pajisjet dhe stabilimentet të cilat hekurudha fqinje i dërgon stacionit kufitar, transportohen pa pagës dhe janë të liruara nga dogana dhe taksat tjera vetëm atëherë nëse kjo është në pajtueshmëri me rregullat doganore.

Valuta me të cilën manipulohet
gjatë kryerjes së shërbimit hekurudhor
Neni 13

Valuta me të cilin manipulohet gjatë kryerjes së shërbimit hekurudhor në trena të cilët e kalojnë kufirin, personeli hekurudhor i hekurudhave fqinje mund ta bartin në territor të hekurudhave amë dhe prapë ta kthejnë në territor të hekurudhave fqinje.

Dërgesat zyrtare
Neni 14

1. Dërgesat zyrtare siç janë: Rregulloret, letrat dhe formularët zyrtar, Orari i lëvizjes së trenave, dërgesat monetare të dedikuara shërbimeve të hekurudhave fqinje ose shërbimet e cekura të cilat duhet t'i dërgohen hekurudhës fqinje, dërgohen me personel zyrtar pa ndërmjetësim të postës dhe pa pagesë të shërbimeve postare.

2. Dërgesat zyrtare të dërguara për shërbime të hekurudhës fqinje duhet të posedojnë vulën e shërbimit i cili i dërgon.

3. Dërgesat nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni i nënshtrohen rregullave doganore dhe revizore, nëse ekziston dyshimi i bazuar që janë shkelë rregullat doganore dhe revizore. Në këtë rast dërgesat e lartcekura me kërkesë të organeve kompetente çilen.

Transporti i personelit zyrtar
Neni 15

Gjatë kryerjes së detyrave të veta zyrtare, Personeli zyrtar hekurudhor udhëton në territor të hekurudhave fqinje pa pagesë, me biletë pa pagesë ose me dokument i cili ia mundëson udhëtimin pa pagesë.

Kontrolli kufitar
Neni 16

1. Sikurse që është paraparë me "Marrëveshje", kontrollin kufitar do ta kryejnë organet kompetente, secili në territorin e shtetit të vet dhe atë:

- MŽ në v.q, Bllacë – kontrollin e trenave për transportimin e udhëtarëve dhe në stacionin kufitar Vollkovë – kontrolli i trenave të mallrave;
- HK në stacionin kufitar Hani i Elezit,

deri sa të përmbyllen marrëveshjet zbatuese të parapara me nenin 14 të "Marrëveshjes", për kontrollin e përbashkët kufitare dhe kontrollin gjatë kohës së udhëtimit.

2. Palët nuk do ta refuzojnë kthimin e udhëtarëve dhe mallrave, hyrjen e të cilëve, përkatësisht importin, e ndalojnë shërbimet kompetente në pajtueshmëri me të drejtën përkatëse.

3. MŽ dhe HK bashkërisht e përcaktojnë normativën teknologjike te kryerja e procedurës kufitare me pëlqim të organeve kompetente dhe i përcaktojnë ato në dispozitat e përbashkëta zyrtare.

Organizimi i veprimtarisë së komunikacionit

Dispozitat themelore
Neni 17

1. Për kryerje e punëve të komunikacionit dhe transportit në stacionet kufitare dhe në seksionin hekurudhor kufitar dhe zbatimi i dispozitave hekurudhore, kompetente janë dispozitat e rregulloreve të aplikueshme, udhëzimeve dhe dispozitave tjera të njërës ose tjetrës hekurudhë, si dhe dispozitat ndërkombëtare.

2. Pranim dorëzimi i trenave, vagonëve,makinave ngarkuese, paletave, kontejnerëve dhe dërgesave të mallrave si dhe dokumenteve përcjellëse, kryhen sipas dispozitave të aplikueshme në komunikacionin ndërkombëtar dhe sipas marrëveshjeve të posaçme të dakorduara ndërmjet të MŽ dhe HK.

3. Lejet për lëshim në qarkullim të mjeteve lëvizëse hekurudhore tërheqëse dhe të tërhequra dhe dëshmitë e aftësimit të personelit zyrtar në territor e njërës hekurudhë, vlejnë edhe në territor të hekurudhës tjetër, nëse posedojnë lejet e nevojshme – certifikatat e lëshuara nga organi kompetent shtetëror.

Pajisjet telekomunikuese dhe sinjalo –siguruese
Neni 18

1. Me qëllim që personelit hekurudhor t'i mundësohet komunikimi ndërmjet veti për rregullimin e komunikacionit hekurudhor , duhet të sigurohen këto ndërlidhje:

- lidhjet telefonike të realizuara nga rrjeti autonom i hekurudhave, e cila duhet të jetë e kyçur në regjistrofon;
- radio lidhjet të realizuara nga rrjeti autonom i hekurudhave, e cila duhet të jetë e kyçur në regjistrofon;
- lidhja e telefaksit dhe
- posta elektronike (e-maili).

2. Pajisjet për vendosje të ndërlidhjeve te organizimi i komunikacionit hekurudhor ndërmjet të stacioneve kufitare lejohet të shfrytëzohen dhe me to mund të operojnë vetëm personat e autorizuar për kryerjen e shërbimit.

3. Stacionet kufitare mund të realizojnë ndërlidhjen dhe varshmërinë reciproke të pajisjeve sinjalo –siguruese në pajtueshmëri me marrëveshjet teknike dhe rregullat e sigurisë.

4. Ndërlidhjet tjera të komunikimit ndërmjet të dy hekurudhave mund të realizohen në bazë të marrëveshjeve reciproke.

Këto ndërlidhje nuk mund të ndërlidhen me rrjetin publik të telekomunikimit, përveç nëse hekurudhat ndryshe nuk pajtohen.

5. Mënyra e realizimit ndërlidhjeve të telekomunikimit, llojet e linjave dhe karakteristikave teknike, sistemet e kyçjes së pajisjeve , numri dhe lloji i ndërlidhjeve të realizuara dhe detajet tjera teknike, përcaktohen me dispozitat e përbashkëta zyrtare. Me këto parashikohen numri dhe vendi i pikave matëse (Kabllot kontrollues dhe ormanët e kabllove, përkatësisht pusetat), mënyra dhe renditja e mënjanimit të pengesave dhe prishjeve, mënyra gjatë vlerësimit së rregullt dhe të jashtëzakonshme, matjet dhe mënjanimi i pengesave dhe detajet tjera të mirëmbajtja të pajisjeve sinjalo-siguruese dhe të telekomunikimit.

Shërbimet për mirëmbajtjen e pajisjeve sinjalo - siguruese dhe të telekomunikimit të hekurudhave fqinje ndërmjet veti, nëse nuk ekziston mundësi tjetër, merren veshë me ndërlidhje telefonike ndërmjet të drejtuesve të trenave dhe rezultatet e matjeve dhe verifikimeve i shënojnë në evidencat të përcaktuara për këtë qëllim.

Shërbimet e autorizuara hekurudhore janë të obliguara menjëherë t'i ndërmarrin masat e duhura për mënjanimin e pengesave dhe për gjendjen e konstatuar ta informojnë hekurudhën fqinje.

Matjet dhe verifikimet e ndërlidhjeve të telekomunikimit sipas UIC njoftimeve) (fishe), do të parashkruhen me marrëveshje të posaçme ndërmjet hekurudhave

6. Ndërtimi, mirëmbajtja dhe ndërrimi i pajisjeve sinjalo-sigurues, pajisjeve telekomunikuese dhe realizimi i ndërlidhjeve tjera dhe ndërlidhjet ndërmjet rrjeteve telekomunikuese të hekurudhave fqinje të vendosura përkohësisht në territor e hekurudhave fqinje, parashihen me marrëveshje të posaçme.

HK – HEKURUDHAT E KOSOVËS
MŽ – MAKEDONSKE ŽEKEZNICE

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 99
Dt. 15-02-2016
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 92
Dt. 15-02-2016
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

МАКЕДОНСКИ ЖЕЛЕЗНИЦИ
ТРАНСПОРТ АД - СКОПЈЕ
Бр. 3671/1
22. 02. 2016 год.
СКОПЈЕ

Јавно претпријатие за железничка инфраструктура
МАКЕДОНСКИ ЖЕЛЕЗНИЦИ
Бр. 851
20 год.
Скопје
22-02-2016

MARRËVESHJE

ZBATUESE PËR NDËRLIDHJE TË RRJETEVE HEKURUDHORE NDËRMJET HEKURUDHAVE TË KOSOVË (HK) DHE HEKURUDHAVE MAQEDONASE (MŽ)

SHKURT 2016

Në bazë të nenit 14 të Marrëveshjes mbi rregullimin e komunikacionit hekurudhor kufitar (në tekstin e mëtejmë "Marrëveshja"), e nënshkruar në Shkup me datën 15.09.2011 ndërmjet qeverive të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës; Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA "Infrakos" dhe Operimi me Trena në Hekurudhat e Kosovës ShA "Trainkos" (në tekstin e mëtejmë HK-Hekurudhat e Kosovës) në njërën anë dhe JPM Infrastruktura dhe MŽ Transport AD - Skopje në tekstin e mëtejmë (MŽ-Hekurudhat Maqedonase) në anën tjetër, janë pajtuar me sa vijon:

MARRËVESHJA ZBATUESE
Për ndërlidhej të rrjetit hekurudhorë ndërmjet HK dhe HM

Dispozitat e përgjithshme
Neni 1

Lëndë e kësaj marrëveshjeje janë aktivitetet të cilat do t'i ndërmarrin palët e marrëveshjes lidhur me rregullimin e komunikacionit hekurudhor ndërmjet të (MŽ) dhe (HK) mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave në zonën kufitare hekurudhore

Përdorimi i termave
Neni 2

Termet e përdorura në këtë marrëveshje kanë këto kuptime:

1. **Marrëveshja** – Nënkupton Marrëveshja mbi Kalimin Kufitar e nënshkruar në Shkup me datën 15.09.2011 ndërmjet qeverive të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës
2. **Hekurudha amë** – nënkupton hekurudhën e cila i përket palës vendore;
3. **Hekurudha fqinje** - nënkupton hekurudhën e cila i përket palës fqinje;
4. **Stacioni kufitar**- nënkupton stacionet hekurudhore të palëve të marrëveshjes afër kufirit të cilat i takojnë zonës hekurudhore;
5. **Hekurudha kufitare** – nënkupton hekurudhën në mes të stacioneve kufitare;
6. **Stacioni i ndërrimit të komunikacionit**- nënkupton stacionin e përbashkët kufitar brenda zonës hekurudhore në të cilin kryhen veprimet e përbashkëta të ndërrimit të komunikacionit;
7. **Linja kufitare** – nënkupton linjën kufitare ndërmjet dy rrjeteve hekurudhore të infrastrukturës të palëve të marrëveshjes;
8. **Seksioni kufitar** – nënkupton pjesën e rrjetit hekurudhor ndërmjet stacionit hekurudhor kufitar dhe linjës kufitare të palëve të marrëveshjes;
9. **Ndërrimi i komunikacionit**- nënkupton mënyrën dhe veprimet rreth pranim-dorëzimit të trenave, vagonëve dhe dërgesat të mallra ndërmjet të dy hekurudhave i cili bëhet në zonën hekurudhore;

10. **Kontrollimi kufitar** – nënkupton veprimet e caktuara të përbashkëta sipas dispozitave të brendshme të cilat kanë të bëjnë me hyrje, daljet dhe transitin e udhëtarëve dhe dërgesave të mallrave;

11. **Personeli zyrtar**- nënkupton personelin e përgjithshëm i cili merr pjesë në kryerjen e komunikacionit hekurudhor kufitar ku bëjnë pjesë:

    - Personeli hekurudhor, dhe
    - Personeli i autorizuar i organeve kompetente (dogana, policia dhe inspekcionet përkatëse);

12. **Dërgesat zyrtare** – nënkupton letrat zyrtare, formularët zyrtar, orarin e lëvizjes, tarifat, si dhe dërgesat me vlerë monetare të destinuara për njësitë zyrtare të hekurudhës fqinje;

13. **Dërgesa** – nënkupton një ose më shumë mallra të cilat transportohen me hekurudhë me një dokument;

14. **Prerja tarifore** - nënkupton pikën e dakorduar në linjën hekurudhore kufitare deri te e cila hekurudhat fqinje kanë të drejt në të ardhura nga transporti i përbashkët i udhëtarëve dhe mallrave;

15. **Përfaqësia** – nënkupton shërbimin me një ose më shumë të punësuar në stacionin e ndërrimit të komunikacionit ose në stacionin kufitar të cilët kryejnë punë për nevoja të hekurudhës së vet në territorin e hekurudhës fqinje;

16. **Zona hekurudhore** – nënkupton territorin e shtetit amë në të cilin personeli zyrtar i shtetit fqinjë është i autorizuar të kryej komunikacionin hekurudhor sipas nenit 3 të Marrëveshjes.

Stacionet kufitare dhe stacioni i ndërrimit të komunikacionit
Neni 3

1. Komunikacioni hekurudhor kufitar për transportimin e udhëtarëve dhe dërgesave të mallrave ndërmjet të MŽ dhe HK do të realizohet në seksionin kufitar Vollkovë - Hani i Elezit.

2. Stacionet kufitare janë:

    - Në MŽ - stacioni Vollkovë,
    - Në HK- stacioni Hani i Elezit.

3. Stacioni i ndërrimit të komunikacionit është stacioni Hani i Elezit për komunikacion të udhëtarëve dhe të mallrave.

4. Prerja tarifore në linjën kufitare Vollkovë - Hani Elezit gjendet në km 313+510

5. Distanca e stacioneve kufitare përcaktohet nga prerja tarifore:

    - Vollkovë – prerja kufitare është 11.718 km
    - Hani Elezit – prerja kufitare – është 1.910 km

Pajisjet, stabilimentet dhe lokalet zyrtare
Neni 4

1. Hekurudha amë i siguron hekurudhës fqinje pajisjet, stabilimentet, lokalet dhe mjetet e ndërlidhjeve në stacionin e ndërrimit të komunikacionit të cilat janë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve, si dhe lokalet për pushim të personelit zyrtar.

2. Për pajisjet, stabilimentet dhe lokalet. nga paragrafi 1 i këtij neni të cilat i janë siguruar hekurudhës fqinje, dhe të cilat ajo i shfrytëzon, hekurudha amë ia faturon pagesën hekurudhës fqinje sipas Marrëveshjes së veçantë.

3. Për komunikim ndërmjet stacioneve kufitare secila hekurudhë në territorin e vet i siguron mjetet e nevojshme të ndërlidhjeve. Ato mjete të ndërlidhjeve, personeli i hekurudhës fqinje do t'i shfrytëzon pa pagesë. Për pajisjet të cilat shfrytëzohen për komunikim në rrjetin publik, shpenzimet i bartin secili shfrytëzues për veti.

4. Kufiri i mirëmbajtjes dhe i mbikëqyrjes së linjës hekurudhore, në parim nënkuptohet prerja e shinave e cila është më e afërt prerjes tarifore. Te sinjalet siguruese dhe pajisjeve të telekomunikimit, kufiri i mirëmbajtjes dhe i mbikëqyrjes është pika testuese e cila është e caktuar ose e ndërtuar për këtë qëllim. Përjashtim bëjnë stabilimentet e jashtme ose të brendshme dhe objektet e telekomunikimit dhe pajisjet e sinjaleve, përkatësisht të linjave ajrore ose të kabllove nëntokësor dhe stabilimentet përcjellëse të tyre, si dhe objektet të cilat shërbejnë për siguri të lëvizjes së trenave të cilat në rast të nevojës sipas rregullave teknike vendosen në territorin e shtetit fqinjë.

Si kufi i mirëmbajtjes dhe mbikëqyrjes caktohet objekti ose vendi për të cilin palët e marrëveshjes janë pajtuar duke e marr parasysh rëndësinë e objekteve të linjës hekurudhore.

Dispozitat më të detajuara për mirëmbajtje të pajisjeve dhe stabilimenteve do të parashkruhen me dispozitat e përbashkëta zyrtare.

5. Çdo modernizim dhe ndryshim të ndërlidhjeve dhe pajisjeve sinjalo siguruese do të kryhet në bazë të marrëveshjeve të posaçme ndërmjet të dy hekurudhave. Gjithashtu hekurudhat ndërmjet veti do të informohen për ndërtimin e ri ose rekonstruktimin dhe zgjerimin e objekteve në territorin e vet të cilat shërbejnë për zhvillimin e komunikacionit kufitar.

Shpenzimet e këtyre ndryshimeve në objekte dhe pajisjet do ti bart hekurudha të cilës i përkasin ato.

Përfaqësia në stacionet e ndërrimit të komunikacionit, përkatësisht në stacionet kufitare
Neni 5

1. Hekurudha fqinje mundet që në stacionin për ndërrimin e komunikacionit, përkatësisht në stacionin kufitar të hapë përfaqësinë e vet me qëllim të mbrojtjes të interesave të hekurudhave të veta. Hekurudha amë me këtë duhet të pajtohet. Shpenzimet e përfaqësisë i bart hekurudha fqinje.

2. Përfaqësia organizon dhe kryen mbikëqyrjen e personelit. Përfaqësia mbron interesat e hekurudhës së vet në të gjitha punët zyrtare të cilat së bashku i kryejnë të dy hekurudhat ose kur hekurudha amë i kryen ato punë për të dy hekurudhat.

Gjatë kohës së kryerjes së shërbimit përfaqësisë duhet ti mundësohet shikueshmëri në shënime zyrtare të cilat hekurudha amë i kryen për hekurudhat fqinje ose për të dy hekurudhat.

Përfaqësia ka të drejt që të bënë përshkrimin ose ekstraktin të atyre shënimeve zyrtare.

3. Përfaqësia është e autorizuar në marrëveshje me shefin e stacionit, drejtpërsëdrejti t'i komenton ose të merr pjesë në hetuesinë e ngjarjeve të jashtëzakonshme të cilat kanë ndodhur , dhe për parregullsitë e vërejtura dhe të pakoordinuara.

4. Përfaqësia nuk është e autorizuar t'i jep asnjë urdhëresë personelit të hekurudhave amë, dhe as të ndërhyn në kryerjen e punëve të tyre.

5. Shkresat zyrtare të dërguara hekurudhës fqinje dhe të pranuara në stacionin e ndërrimit të komunikacionit ose në përfaqësi, dorëzohen bashkërisht.

6. Përfaqësia e hekurudhave fqinje ka të drejt që lokalet zyrtare të ndara në territorin e hekurudhave amë t'i shënon me shenjën dhe mbishkrimin e hekurudhave të veta. Mbishkrimi mbi lokale- zyrave shkruhet me shkrim zyrtar, ashtu që në rend të parë shënohet mbishkrimi i hekurudhave fqinje.

Rregullimi në lidhje me këtë pikë duhet t'i përshtatet gjendjes së përgjithshme të objektit të stacionit, për të cilën pajtohen përfaqësia me shefin e stacionit.

7. Numri i punëtorëve të hekurudhave fqinje të cilët kryejnë shërbimin në stacionin e ndërrimit të komunikacionit caktohet me marrëveshje, njëherë në vit dhe mund të ndryshohet sipas nevojës.

8. Gjatë kryerjes së punëve në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, paraprakisht në stacionet kufitare, personeli i hekurudhave fqinje mund të lëvizë dhe të qëndron në territor të stacionit dhe në lokalet zyrtare të domosdoshme për kryerjen e punëve.

Rendi dhe siguria në seksionin hekurudhor kufitar
Neni 6

1. Organet përkatëse në secilën anë të kufirit janë të obliguara për sigurim të rendit dhe sigurisë në seksionin hekurudhor kufitar.

2. Gjatë kohës së kryerjes së punëve në trena të cilët lëvizin në seksionin kufitar , personeli i hekurudhave fqinje, në rast të rrezikimit të rendit dhe sigurisë në komunikacionin hekurudhor doemos duhet ta informojnë stacionin kompetent të hekurudhave amë.

Gjuha punuese
Neni 7

1. Gjuhët punuese për komunikim me personelin zyrtar të hekurudhave fqinje në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, përkatësisht në stacionet kufitare dhe seksionin kufitar janë: Gjuha Shqipe, Maqedonase , Serbe dhe Angleze.

2. Komunikimet telefonike, informatat e shkruara dhe gojore që kanë të bëjnë me lëvizjen e trenave, duhet të udhëhiqen në njërën nga gjuhët e cekura të punës.

3. Personeli zyrtar i të dyja hekurudhave duhet t'i njohë gjuhët e lartcekura.

Pozita juridike e personelit hekurudhor
Neni 8

1. Personeli hekurudhor i cili kryen shërbim në lidhje me këtë marrëveshje në anën tjetër të kufirit i nënshtrohet normave juridike të asaj gjykate përkatëse.

2. Personeli hekurudhor i cili kryen shërbim në anën tjetër të kufirit, duhet të sillet në harmoni të fqinjësisë së mirë të marrëdhënieve të dy hekurudhave, si në kohë të shërbimit ashtu dhe jashtë saj.

3. Personeli zyrtar i hekurudhës amë është i obliguar që personelit të hekurudhës fqinje t'i ofron ndihmën e nevojshme dhe mbrojtjen gjatë kryerjes të detyrës së tyre zyrtare.

4. MŽ dhe HK i ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje të plot juridike zyrtarëve të vetë në territorin e hekurudhës fqinje.

5. MŽ dhe HK janë të obliguara që të informohen ndërmjet veti për veprimet ndëshkuese të cilat personeli zyrtar i hekurudhave fqinje i ka kryer në territor të hekurudhave amë.

6. Shërbimi përkatës i hekurudhave fqinje është i obliguar që në kërkesë të shërbimit përkatës të hekurudhave amë menjëherë ta revokoj zyrtarin e vetë. Kërkesa për revokim nuk ka nevojë për arsyetim.

Ndihma mjekësore
Neni 9

Personelit hekurudhor të hekurudhave fqinje, në rast të sëmundjes ose lëndimit në zonën hekurudhore, në stacionin kufitar dhe në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, respektivisht edhe më larg nga stacioni, në rastet e parapara në nenin 3 të kësaj marrëveshje, ose gjatë kohës së ofrimit të ndihmës me shërbime të tërheqjes, hekurudha amë pa pagesë i ofron ndihmën e parë të nevojshme.

Kalimi i kufirit dhe qëndrimi në anën tjetër të kufirit.
Neni 10

1. Personeli hekurudhor, duke e përfshirë edhe personelin mbikëqyrës, gjithashtu edhe personelin i cili merr pjesë në hetuesinë dhe eliminimin e pasojave të ngjarjes së jashtëzakonshme, duhet të ketë fletë lëshimin zyrtar për kalim të kufirit ose të jetë evidentuar në regjistrin e personave të cilët e kalojnë kufirin për nevoja zyrtare, në harmoni me nenin 10 të Marrëveshjes.

2. Punëtorët për mirëmbajtjen e linjës hekurudhore, pajisjeve SS dhe TK për eliminim të pengesave dhe kontrollin e pajisjeve, mund të kalojnë kufirin edhe në këmbë nëpër binar. Për këtë lloj të kalimit të kufirit, paraprakisht duhet të informohen organet doganore, Policia kufitare dhe të paralajmërohen edhe organet fqinje, dhe tek pasi që të merret pëlqimi nga ato organe mund të kalohet kufiri shtetëror.

3. Punëtorët e hekurudhës fqinje, pas kalimit të kufirit dhe arritjes në stacionin kufitar të hekurudhës fqinje, duhet që menjëherë ta lajmërojnë drejtuesin e trenave kujdestar për arritjen e tyre. Gjithashtu, para nisjes duhet ta lajmërojnë drejtuesin e trenave kujdestar në stacionin në të cilin kanë kryer shërbimin.

4. Punëtorët e MŽ dhe HK, gjatë kryerjes së detyrave të punës në stacionet kufitare, stacionet e ndërrimit të komunikacionit ose në seksionet kufitare të hekurudhave fqinje, nuk guxojnë të lëshojnë dalin jashtë territorit të stacionit dhe seksionit hekurudhor në të cilin kanë kryer punë.

Uniforma zyrtare dhe armatimi
Neni 11

1. Personeli hekurudhor i cili kryen shërbim në territorin e hekurudhës tjetër duhet të bart uniformen ose shenjat zyrtare të dukshme të hekurudhës së vet në kohën e shërbimit dhe në kohën e ardhjes dhe vajtjes nga puna.

2. Personeli hekurudhor nuk guxon të mbaj armë gjatë kohës të kryerjes së shërbimit.

Lehtësirat doganore për gjësendet për përdorim vetanak për personel hekurudhor dhe gjësendet e dedikuar për përdorim të shërbimit hekurudhor
Neni 12

1. Të gjitha gjësendet të dedikuara për përdorim vetanak dhe për shërbim, të cilat personeli hekurudhor i hekurudhave fqinje gjatë kryerjes se punëve dhe detyrave të punës i bartin ose qesin jashtë kufirit , janë të liruara nga pagesa doganore dhe taksat tjera.

2. Gjësendet e dedikuara për shërbimin hekurudhor, materiali dhe pjesët rezervë të nevojshme për riparimin dhe mirëmbajtjen të parkut të vetë lëvizës, pajisjet dhe stabilimentet të cilat hekurudha fqinje i dërgon stacionit kufitar, transportohen pa pagës dhe janë të liruara nga dogana dhe taksat tjera vetëm atëherë nëse kjo është në pajtueshmëri me rregullat doganore.

Valuta me të cilën manipulohet
gjatë kryerjes së shërbimit hekurudhor
Neni 13

Valuta me të cilin manipulohet gjatë kryerjes së shërbimit hekurudhor në trena të cilët e kalojnë kufirin, personeli hekurudhor i hekurudhave fqinje mund ta bartin në territor të hekurudhave amë dhe prapë ta kthejnë në territor të hekurudhave fqinje.

Dërgesat zyrtare
Neni 14

1. Dërgesat zyrtare siç janë: Rregulloret, letrat dhe formularët zyrtar, Orari i lëvizjes së trenave, dërgesat monetare të dedikuara shërbimeve të hekurudhave fqinje ose shërbimet e cekura të cilat duhet t'i dërgohen hekurudhës fqinje, dërgohen me personel zyrtar pa ndërmjetësim të postës dhe pa pagesë të shërbimeve postare.

2. Dërgesat zyrtare të dërguara për shërbime të hekurudhës fqinje duhet të posedojnë vulën e shërbimit i cili i dërgon.

3. Dërgesat nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni i nënshtrohen rregullave doganore dhe revizore, nëse ekziston dyshimi i bazuar që janë shkelë rregullat doganore dhe revizore. Në këtë rast dërgesat e lartcekura me kërkesë të organeve kompetente çilen.

Transporti i personelit zyrtar
Neni 15

Gjatë kryerjes së detyrave të veta zyrtare, Personeli zyrtar hekurudhor udhëton në territor të hekurudhave fqinje pa pagesë, me biletë pa pagesë ose me dokument i cili ia mundëson udhëtimin pa pagesë.

Kontrolli kufitar
Neni 16

1. Sikurse që është paraparë me "Marrëveshje", kontrollin kufitar do ta kryejnë organet kompetente, secili në territorin e shtetit të vet dhe atë:

- MŽ në v.q, Bllacë – kontrollin e trenave për transportimin e udhëtarëve dhe në stacionin kufitar Vollkovë – kontrolli i trenave të mallrave;
- HK në stacionin kufitar Hani i Elezit,

deri sa të përmbyllen marrëveshjet zbatuese të parapara me nenin 14 të "Marrëveshjes", për kontrollin e përbashkët kufitare dhe kontrollin gjatë kohës së udhëtimit.

2. Palët nuk do ta refuzojnë kthimin e udhëtarëve dhe mallrave, hyrjen e të cilëve, përkatësisht importin, e ndalojnë shërbimet kompetente në pajtueshmëri me të drejtën përkatëse.

3. MŽ dhe HK bashkërisht e përcaktojnë normativën teknologjike te kryerja e procedurës kufitare me pëlqim të organeve kompetente dhe i përcaktojnë ato në dispozitat e përbashkëta zyrtare.

Organizimi i veprimtarisë së komunikacionit

Dispozitat themelore
Neni 17

1. Për kryerje e punëve të komunikacionit dhe transportit në stacionet kufitare dhe në seksionin hekurudhor kufitar dhe zbatimi i dispozitave hekurudhore, kompetente janë dispozitat e rregulloreve të aplikueshme, udhëzimeve dhe dispozitave tjera të njërës ose tjetrës hekurudhë, si dhe dispozitat ndërkombëtare.

2. Pranim dorëzimi i trenave, vagonëve,makinave ngarkuese, paletave, kontejnerëve dhe dërgesave të mallrave si dhe dokumenteve përcjellëse, kryhen sipas dispozitave të aplikueshme në komunikacionin ndërkombëtar dhe sipas marrëveshjeve të posaçme të dakorduara ndërmjet të MŽ dhe HK.

3. Lejet për lëshim në qarkullim të mjeteve lëvizëse hekurudhore tërheqëse dhe të tërhequra dhe dëshmitë e aftësimit të personelit zyrtar në territor e njërës hekurudhë, vlejnë edhe në territor të hekurudhës tjetër, nëse posedojnë lejet e nevojshme – certifikatat e lëshuara nga organi kompetent shtetëror.

Pajisjet telekomunikuese dhe sinjalo –siguruese
Neni 18

1. Me qëllim që personelit hekurudhor t'i mundësohet komunikimi ndërmjet veti për rregullimin e komunikacionit hekurudhor , duhet të sigurohen këto ndërlidhje:

- lidhjet telefonike të realizuara nga rrjeti autonom i hekurudhave, e cila duhet të jetë e kyçur në regjistrofon;
- radio lidhjet të realizuara nga rrjeti autonom i hekurudhave, e cila duhet të jetë e kyçur në regjistrofon;
- lidhja e telefaksit dhe
- posta elektronike (e-maili).

2. Pajisjet për vendosje të ndërlidhjeve te organizimi i komunikacionit hekurudhor ndërmjet të stacioneve kufitare lejohet të shfrytëzohen dhe me to mund të operojnë vetëm personat e autorizuar për kryerjen e shërbimit.

3. Stacionet kufitare mund të realizojnë ndërlidhjen dhe varshmërinë reciproke të pajisjeve sinjalo –siguruese në pajtueshmëri me marrëveshjet teknike dhe rregullat e sigurisë.

4. Ndërlidhjet tjera të komunikimit ndërmjet të dy hekurudhave mund të realizohen në bazë të marrëveshjeve reciproke.

Këto ndërlidhje nuk mund të ndërlidhen me rrjetin publik të telekomunikimit, përveç nëse hekurudhat ndryshe nuk pajtohen.

5. Mënyra e realizimit ndërlidhjeve të telekomunikimit, llojet e linjave dhe karakteristikave teknike, sistemet e kyçjes së pajisjeve , numri dhe lloji i ndërlidhjeve të realizuara dhe detajet tjera teknike, përcaktohen me dispozitat e përbashkëta zyrtare. Me këto parashikohen numri dhe vendi i pikave matëse (Kabllot kontrollues dhe ormanët e kabllove, përkatësisht pusetat), mënyra dhe renditja e mënjanimit të pengesave dhe prishjeve, mënyra gjatë vlerësimit së rregullt dhe të jashtëzakonshme, matjet dhe mënjanimi i pengesave dhe detajet tjera të mirëmbajtja të pajisjeve sinjalo-siguruese dhe të telekomunikimit.

Shërbimet për mirëmbajtjen e pajisjeve sinjalo - siguruese dhe të telekomunikimit të hekurudhave fqinje ndërmjet veti, nëse nuk ekziston mundësi tjetër, merren veshë me ndërlidhje telefonike ndërmjet të drejtuesve të trenave dhe rezultatet e matjeve dhe verifikimeve i shënojnë në evidencat të përcaktuara për këtë qëllim.

Shërbimet e autorizuara hekurudhore janë të obliguara menjëherë t'i ndërmarrin masat e duhura për mënjanimin e pengesave dhe për gjendjen e konstatuar ta informojnë hekurudhën fqinje.

Matjet dhe verifikimet e ndërlidhjeve të telekomunikimit sipas UIC njoftimeve) (fishe), do të parashkruhen me marrëveshje të posaçme ndërmjet hekurudhave

6. Ndërtimi, mirëmbajtja dhe ndërrimi i pajisjeve sinjalo-sigurues, pajisjeve telekomunikuese dhe realizimi i ndërlidhjeve tjera dhe ndërlidhjet ndërmjet rrjeteve telekomunikuese të hekurudhave fqinje të vendosura përkohësisht në territor e hekurudhave fqinje, parashihen me marrëveshje të posaçme.

7. Eksploatimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve telekomunikuese dhe sinjalo-siguruese dhe zhvillimi ndërtimi i tyre koordinuar, realizohet me bashkëpunim të përbashkët të shërbimeve të autorizuara të dy hekurudhave .

Qarkullimi i trenave
Neni 19

1. Qarkullimi i trenave në linjat kufitare rregullohet në bazë të marrëveshjes së përbashkët të orarit të lëvizjes së trenave të dy hekurudhave.

2. Orari i lëvizjes së trenave dakordohet dhe harmonizohet një herë në vit dhe mund të ndryshohet vetëm në bazë të marrëveshjes së dy hekurudhave në pajtueshmëri me Ekspozeun (Deklaratën) e rrjetit.

3. Të dy hekurudhat janë të obliguara që njëra tjetrës të ia dërgojnë të botuar materialin e Orarit të lëvizjes së trenave, në sasinë e nevojshme për zhvillim normal të komunikacionit kufitar.

Tërheqja e trenave
Neni 20

1. Tërheqja e trenave në linjat kufitare hekurudhore me marrëveshje definohet për çdo orar të lëvizjes së trenave.

2. Hekurudhat munden që me marrëveshje të posaçëmve të pajtohen për organizimin e tërheqjes së trenave edhe më larg se stacioni i ndërrimit të komunikacionit ose të stacionit kufitar.

Tërheqja e trenave në këto relacione me marrëveshje e përcaktohet për çdo orar të lëvizjes së trenave.

3. Secila hekurudhë mirëmban dhe i furnizon parkun e vetë të mjeteve lëvizëse hekurudhore tërheqëse.

4. Në rast të defektit, mjetet lëvizëse tërheqëse me pëlqim të hekurudhës pronare kthehen në domicil (në stacionin amë), por nëse kjo nuk është e mundur, hekurudhat merren vesh për zgjidhjen e problemit.

5. Nëse në stacionet e ndërrimit të komunikacionit nuk ka tren të gatshëm për nisje, atëherë lokomotiva e arritur me ndonjë tren duhet të kthehet së bashku me personelin si tren lokomotivë, më së voni sipas orarit të lëvizjes së trenit sipas të cilit është dashur të kthehet. Pas asaj kohe, lokomotiva dhe personeli mund të qëndrojë vetëm me pëlqimin e hekurudhës fqinje (Shërbimit operativ).

Rregullimi i lëvizjes së trenave ndërmjet stacioneve kufitare
Neni 21

1. Lëvizja e trenave ndërmjet stacioneve kufitare zhvillohet në distancë të stacioneve.

2. Informatat në lidhje me lëvizjen e trenave në komunikacionin ndërkombëtar jepen përmes radio lidhjeve të kyçura në regjistrofon ose përmes tel-faksit, ose përmes mjeteve tjera të telekomunikimit të cilat janë të pranuara për rregullim të lëvizjes së trenave.

3. Nëse regjistrofoni është në prishje, shfrytëzohet tele-faksi ose mjetet tjera të telekomunikimit të cilat janë të pranuara për rregullim të lëvizjes së trenave.

4. Në rast të ndërprerjes totale të mjeteve të ndërlidhjeve, lëvizja e trenave nuk do të zhvillohet deri sa nuk vendoset ndërlidhja.

5. Komunikatat të cilat kanë të bëjnë me lëvizjen e trenave, regjistrohen në ditarë të komunikacionit.

6. Për lëvizjen e trenave duhet të kërkohet dhe të jepet leja (miratimi) për lëvizjen e tyre. Në miratimin e kërkuar duhet të përgjigjet më së voni në afat prej 5 minutave dhe pas nisjes të trenit menjëherë duhet informohet pala tjetër.

7. Nëse treni nuk përcillet (niset) në afat prej 10 minutave, miratimi i pranuar duhet të anulohet. Kur treni prapë të jetë i gatshëm për nisje, duhet të kërkohet miratim i ri.

8. Nëse ndryshe nuk është e parashkruar, stacioni i cili e pranon trenin menjëherë pas arritjes së tij duhet të ia lajmërojë arritjen stacionit të nisjes.

9. Ndërmjet të stacioneve kufitare, është e ndaluar ndalja e trenave të mallrave. Nëse ndodhë që treni të ndalet, stacioni kufitar i hekurudhës në territorin e së cilës është ndalur treni, duhet t'i lajmërojë organet kompetente të cilat do të japin udhëzimin si të veprohet tutje.

Në territorin e MŽ, trenat për transportimin e udhëtarëve, në të dy drejtimet do të ndalen në v.q Bllace, ku organet kompetente do t'i kryejnë formalitetet kufitare dhe doganore. Veprimet e personelit të trenit në vendqëndrimin Bllace, janë të parapara me udhëzim të posaçëm të MŽ.

10. Lëvizja e trenave dhe drezinave hekurudhore deri te një pikë e caktuar në linjën hekurudhore kufitare parashihen me Dispozita të përbashkëta zyrtare.

11. Kohen e punës të stacioneve kufitare e përcaktojnë hekurudhat me marrëveshje.

12. Gjatë kohës së punës, stacionet kufitare duhet në çdo 6 orë t'i japin njëra tjetrës komunikatën për lëvizjen e trenave.

13. Nëse ndryshe nuk është e paraparë, për vonesat e trenave të udhëtarëve më të gjata se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta dhe trenave të mallrave 30 (tridhjetë) minuta, stacionet kufitare duhet të informohen reciprokisht.

14. Për lëvizjen e trenave ndërmjet kufirit dhe stacionit kufitar përdoren sinjalet e përhershëm, sinjalet bartëse dhe sinjalet e personelit të linjave hekurudhore të hekurudhës amë. Komunikimi ndërmjet personelit shoqëruese të trenave dhe personelit të mjetit lëvizës tërheqës realizohet sipas dispozitave të komunikacionit dhe sinjalizimit të hekurudhës e cila realizon tërheqjen e trenave.

Në stacionet kufitare vlejnë dispozitat e komunikacionit dhe të sinjalizimit të hekurudhës amë. Në pikëpamje të përbërjes, ngarkesës dhe frenimit të trenave, vlejnë dispozitat e parapara nga materiali i orarit të lëvizjes së trenave.

15. Personeli i trenit i hekurudhës fqinje në linjat hekurudhore të hekurudhë amë duhet t'i përmbahen Rregulloreve të aplikueshme në ato hekurudha. Në harmoni me këtë duhet në masë të mjaftueshme t'i njoh ato dhe të kenë provimin e dhënë te njësia e vet e autorizuar. Lëndën e provimit e përbëjnë dallimet në rregulloret të cilat aplikohen në komunikacionin kufitar ndërmjet dy hekurudhave.

Dallimet në rregulloret ndërmjet MŽ dhe HK do të hartohen dhe publikohen si "Ekstrat i dispozitave nga rregulloret e (MŽ) dhe (HK) të cilat ndërmjet veti dallojnë reciprokisht e të cilat aplikohen në komunikacionin kufitar " si dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme të atyre rregullave. Të dy hekurudhat do të përkujdesen për shkollimin e personelit të interesuar. Për të gjitha ndryshimet e këtyre rregullave, ja komunikojnë hekurudhave fqinje 30 dit para hyrjes në aplikim.

16. Për trenat të cilët lëvizin ndërmjet stacioneve kufitare, hekurudha e cila e realizon tërheqjen duhet të udhëheqë dokumentacionin e trenit i cili është paraparë në atë hekurudhë.

Në Dispozitat e përbashkëta zyrtare, hekurudhat do të përcaktojnë veprimet për dokumentet përcjellëse të trenit.

17. Hekurudha e cila i tërheq trenat duhet të siguron mjetet tërheqëse dhe personelin për të gjitha trenat e rregullt dhe për trenat e jashtëzakonshëm në kohën e duhur të vënë në lëvizje.

18. Lejohet përcjellja e trenave të mallrave para kohe. Për këtë për çdo rast veç e veç merren vesh stacionet kufitare.

19. Për mbyllje të planifikuar të linjës, hekurudhës (binarit), hekurudhat duhet të informohen reciprokisht 8 ditë më parë. Pranimi i informatës duhet vërtetuar. Me mbylljen e linjës hekurudhore mund të fillohet vetëm pasi që të pranohet konfirmimi.

Për fillimin dhe përfundimin e mbylljes së planifikuar dhe të pa planifikuar, stacionet kufitare reciprokisht duhet të informohen.

20. Për vozitjet e ngadalësuara ose të revokimit të trenave, stacionet kufitare duhet reciprokisht të informohen.

21. Shpejtësia më e madhe e lejuar, masa e trenit, përqindja e frenimit, gjatësia e trenit dhe ngarkesa për bosht dhe metër gjatësi do të parashihen me Dispozitat e përbashkëta zyrtare.

Llogaritja e kohës
Neni 22

Te realizimi i lëvizjeve së trenave në komunikacionin ndërkufitar hekurudhor, koha matët sipas matjes në Evropën e mesme. Për çdo ditë barazimi i kohë bëhet në ora 12.00.

Përgatitja dhe përbërja e trenave
Neni 23

1. Përbërja dhe përcjellja e trenit duhet të përcaktohen me materialet e orarit të lëvizjes së trenave.

2. Në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, kontrollimin teknik të trenit e kryen kontrolluesi i vagonëve i hekurudhës e cila e pranon trenin dhe atë në prezencë të kontrolluesit të vagonëve të hekurudhës e cila e dorëzon trenin. Nëse ndonjë vagon nuk pranohet për shkak të ndonjë mungese, ai largohet nga përbërja e trenit dhe menjëherë vendoset në trenin e drejtimit të kundërt. Nëse momentalisht nuk ka tren të tillë, vagoni i ngjitët lokomotivës së parë e cila kthehet mbrapa.

E njëjta procedurë përsëritet edhe nëse vagoni nuk pranohet për shkaqe të transportit (komercial).

3. Lidhjen dhe zgjidhjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore e kryen personeli i hekurudhave amë. Kushtet e lëvizjes së mjeteve tërheqëse të hekurudhës fqinjë në stacionin kufitar të hekurudhës amë do të përcaktohen me Dispozitat e përbashkëta zyrtare.

4. Personeli i trenit dhe personeli tjetër i cili ndodhet në territorin e hekurudhës fqinje, duhet t'i respektoj urdhëresat zyrtare të zyrtarëve kompetent të hekurudhës amë të dhëna në lidhje me lëvizjen e trenave.

5. Gjatë kohës së qëndrimit në territorin e hekurudhës fqinje, rreth shërbimit dhe gjendjes së mjeteve lëvizëse për tërheqje përgjegjës është personeli i mjetit lëvizës tërheqës , nëse ndryshe nuk është dakorduar..

GSh

Kryerja e punëve manovruese në stacionin e ndërrimit të komunikacionit
Neni 24

1. Në stacionet e ndërrimit të komunikacionit, manovrimet i kryejnë hekurudha -amë me lokomotivë dhe personel të vetin.

2. Manovrimi me lokomotivë të hekurudhave fqinje në stacionin e ndërrimit të komunikacionit nuk lejohet, përveç në rastet e posaçme gjatë kontrollimit teknik të trenit për manovrim ku mund të përdoret edhe lokomotiva e hekurudhave fqinje nëse është e nevojshme që vagoni i posaçëm të radhitet ose të ndahet nga treni i vet në njërin nga binarët fqinjë.

Pranim-dorëzimi i trenave të udhëtarëve
Neni 25

1. Pranim – dorëzimi i vagonëve të udhëtarëve ndërmjet të hekurudhave kryhet konform rregullave të rregullores RIC dhe marrëveshjeve të përbashkëta bilaterale.

2. Me pranim-dorëzim të vagonëve të arritur duhet të fillohet menjëherë si të arrin treni në stacionin e ndërrimit të komunikacionit sipas teknologjisë të paraparë me Dispozitat e përbashkëta zyrtare, duke e marr parasysh kohë - zgjatjen e kontrollit kufitar, ashtu që pranim – dorëzimi të kryhet me kohë para kohës së caktuar për nisjen e trenit sipas orarit.

Pranim – dorëzimi i trenave për transportin e mallrave
Neni 26

1. Pranim-dorëzimi i dërgesave dhe vagonëve bëhet në bazë të Konventave dhe rregulloreve ndërkombëtare:

- Konventa për transportin hekurudhor ndërkombëtar COTIF
- Rregullat uniforme CIM
- Marrëveshja e përgjithshme mbi shfrytëzimin e vagonëve të mallrave OUK (AVV)
- Rregullores RID
- Marrëveshja mbi komunikacionin hekurudhor ndërkombëtar të mallrave SMIGS
- RIV (95), fletorja 1, 2, 3
- Doracaku mbi komunikacionin e mallrave CIT (GTM-CIT)
- Doracaku mbi fletë ngarkesën CIM (GLV-CIM)
- Doracaku mbi fletë ngarkesën CIM për komunikacion të kombinuar (GLV-TC)
- Doracaku për fletën e vagonëve CUV (GLW-CUV)
- Doracaku mbi zbatimin praktik OUK

Te komunikacioni ndërkombëtar i mallrave ndërmjet dy hekurudhave, lejohet shmangia nga Marrëveshja e përgjithshme mbi shfrytëzimin e vagonëve të mallrave OUK (AVV), në bazë të marrëveshjes plotësuese ndërmjet tyre, duke i kyçur edhe hekurudhat tjera të cilat janë nënshkruese të marrëveshjes së tillë dhe si të tilla marrin pjesë me vagonët e vetë në përbërjen e trenit.

2. Inspektimin komercial sipas rregullit bashkërisht e bëjnë përfaqësuesit e hekurudhave pranuese dhe dorëzuese në suaza të kohës teknologjike nga dispozitat zyrtare të përbashkëta.

3. Pranim-dorëzimi i dërgesave në vagonët e hapur me mbulesa, me kontejnerë dhe vagonët e mbyllur të pllombuar, bëhet simbolikisht në krahasim me dokumentin transportues, dokumentet përcjellëse dhe Listës për kalim K-200. Këto dërgesa duhen me qenë të pllombuara së paku me një pllombë të pranuar zyrtarisht (të hekurudhës, të doganës ose pllombën e dërguesit e cila është zyrtarisht e pranuar), në pajtueshmëri me Shtojcën 24 nga Doracaku për komunikacionin e mallrave GTM-CIT.

Nëse dërguesi i vagonit e ka vënë pllombën e vetë të pranuar zyrtarisht, ai duhet ta shënoi numrin dhe shenjën në rubrikën 21 të fletë ngarkesës CIM. Mirëpo, nëse dërguesi i vagonit e ka vënë pllombën e vetë duke mos i evidentuar në fletë ngarkesë të dhënat mbi pllombën, ajo nuk është shkas që vagoni të përjashtohet nga pranimi te pranim-dorëzimi.

Pranim-dorëzimi i dërgesave në vagonët e hapur pa mbulesa, bëhet faktikisht.

4. Lista mbi kalimin K-200 hartohet në pesë kopje, prej të cilave 2 kopje për nevojat e HK- Trainkos dhe 2 kopje për nevojat e MŽ Transport mbetet te përfaqësuesi i hekurudhës dorëzuese, ndërsa 4 (katër) ekzemplarë i dorëzohen përfaqësuesit të hekurudhës pranuese e cila pas mbarimit të pranim-dorëzimit ia kthen numër të paraparë ekzemplar të vërtetuar hekurudhës dorëzuese. Hekurudhat pranuese dhe dorëzuese e vërtetojnë pranim-dorëzimin e kryer me vulë dhe nënshkrim të përfaqësuesve të vetë. Në Listën mbi kalimin K-200 shënohen vagonët e trenit (të ngarkuar dhe bosh), si dhe mjetet lëvizëse tërheqëse jashtë punës kur lëvizin si dërgesa.

5. Koha e pranim-dorëzimit të trenit është koha e arritjes së trenit në stacionin e ndërrimit të komunikacionit nga drejtimi i hekurudhës fqinje. Te trenat të cilët nisen nga stacioni i ndërrimit të komunikacionit kah hekurudha fqinje, koha e pranim-dorëzimit është koha e pranim-dorëzimit të dokumenteve përfaqësuesit të hekurudhës fqinjë.

Në rast se gjatë inspektimit komercial dhe/ose teknik vërtetohet parregullsi e cila kërkon përjashtimin e vagonit nga treni, vagoni i cili është refuzuar për pranim me një vizë fshihet në VAG-65 dhe K-200, duke e shënuar shkakun e refuzimin në rubrikën "Vërejtje", si dhe kohën dhe datën e refuzimit, të cilat vërtetohen me nënshkrimin e përfaqësuesit të hekurudhës pranuese. Me atë rast, mbajta e trenit nga momenti i dhënies së orarit të manovrimit, deri në momentin e përfundimit të manovrës, shkaku i përjashtimit të vagonit nga treni, bien në barrë të hekurudhës dorëzuese. Manovrimi bëhet në suaza të kohës së paraparë nga dispozitat e përbashkëta zyrtare.

Nëse gjatë kryerjes së provës së frenave, para nisjes së trenit, vërtetohet parregullsi e frenave e cila kërkon përjashtimin e vagonit nga treni ose ndryshimin e përbërjes së trenit, vagoni dërgimi i mëtejmë i të cilit është i pamundur, mund të refuzohet për pranim.

Gjatë ndryshimit të përbërjes së trenit, vagonët dhe treni llogariten të pranuara vetëm pas nënshkrimit të provës së frenave dhe pas kryerjes së manovrës.

6. Në bazë të dokumenteve përcjellëse me shtojca të pranuar dhe pas kryerjes së inspektimit komercial dhe teknik të dërgesave dhe vagonëve, përfaqësuesi i hekurudhës pranuese e shënon kohën e pranimit në Listën për kalim K-200, në pajtueshmëri me pikën 5 të këtij neni. Përmirësimet dhe ndryshimet eventuale në Listën për kalim K-200 duhen të bëhen ashtu që, teksti i mëparshëm të mbetet i dukshëm. Përmirësimet duhen të vërtetohen me nënshkrim të përfaqësuesit të hekurudhës dorëzuese.

7. Refuzimi i pranimit të dërgesës mund të ndodh vetëm në kuptim të Listës punuese 03.02. nga Doracaku mbi komunikacionin e mallrave CIT (GTM-CIT), bashkë me citimin e shkakut në Listën për kalim K-200. Në rast kontesti rreth pranimit të dërgesës, kompetent është mendimi i transportuesit i cili e pranon dërgesën. Hekurudha dorëzuese vendosë që mangësitë dhe vërejtjet a do të mënjanohet menjëherë ose dërgesa do të refuzohet. Dërgesa e refuzuar i kthehet hekurudhës dorëzuese me trenin e parë të përshtatshëm ose me makinën e parë e cila kthehet rezhi.

Në rast se tregohet nevoja për shkarkim-ngarkim të dërgesës ose për përmirësimin e ngarkesës, e në kërkesë të hekurudhës dorëzuese dhe nëse ajo është e mundur, hekurudha pranuese do ta bëjë përmirësimin e ngarkesës, respektivisht shkarkim-ngarkimin e dërgesës në shpenzime të hekurudhës dorëzuese.

8. Dërgesat e pranuara për të cilat është nënshkruar Lista për kalim K-200, e të cilat janë refuzuar nga shërbimet kompetente shtetërore (dogana, policia, inspekcioni), në afatin më të shkurtër të mundshëm duhet të kthehen në shtetin fqinjë, gjegjësisht me trenin e parë të përshtatshëm. Hekurudha dorëzuese duhet ta pranoi dërgesën e tillë. Personi i autorizuar i hekurudhës pranuese duhet t'i shlyej duke u rënë vijë vagonët e refuzuar për pranim në Listën për kalim K-200, ndërsa në rubrikën Vërejtje të shënohen shkaqet për refuzimin e vagonit (dërgesës) dhe ta vërtetoi me nënshkrim dhe vulën e vetë, duke e cituar kohen e refuzimit të vagonit.

9. Pllombat hekurudhore doganore dhe të dërguesit të pranuara zyrtarisht, pranohen reciprokisht nëse të njëjtat nuk janë të dëmtuara.

10. Personi i autorizuar e nënshkruan Listën për kalim K-200, procesverbalin dhe dokumentet tjera mbi punën e përbashkët të personelit të dyja hekurudhave, si edhe përmirësimet, ndryshimet dhe plotësimet të atyre përmirësimeve.

Nëse personi i autorizuar i njërës hekurudhë nuk është i pajtueshëm me citatet, por duhet të njëjtat t'i nënshkruaj, me vërejtje se nuk pajtohet, duke i cituar dhe sqaruar shkaqet në mënyrë të shkruar.

11. Nëse refuzohet pranimi i vagoni, respektivisht dërgesës nga shkaqet teknike ose komerciale, dhe kur personeli kujdestar i HK dhe HM nuk munden të pajtohen, duhet të formohet komisioni i shkallës së parë i përbashkët nga përfaqësuesit e HK – Trainkos nga njëra anë dhe JP MŽ Infrastruktura – Skopje dhe ose MŽ Transport Ad- Skopje në anën tjetër do sjell vendimin përfundimtar .

Nëse komisioni e konstaton se vagoni, ose dërgesat janë pa arsye, vagonët pranohet me datë dhe kohë të pranim-dorëzimit të trenit ku kanë qenë të radhitur, kur ka ardhur deri te mosmarrëveshja, si dhe vagonët tjerë nga trenat në arritje, për kohën e zvogëluar për punën manovrës rreth përjashtimit të vagonëve kontestues..

Nëse komisioni i shkallës së parë nuk mund të pajtohet rreth pranimit ose të refuzimit të vagonit, kyçet komisioni i shkallës së dytë. Veprimi i komisionit të shkallës së dytë parashihet me dispozitat e përbashkëta zyrtare.

Ngjarjet e jashtëzakonshme
Neni 27

1. Kur ndërmjet dy stacioneve kufitare në linjën e hapur hekurudhore, ndodh ngjarja e jashtëzakonshme, stacioni kufitar i cili i pari njoftohet për të, duhet ta informoi menjëherë stacionin tjetër kufitar.

2. Mënjanimi i pasojave të ngjarjes së jashtëzakonshme bien në detyrë të hekurudhës në territorin e së cilës ka ndodhur ngjarja e jashtëzakonshme. Nëse është e nevojshme, njëra hekurudhë ka të drejtë të kërkoi ndihmë nga hekurudha tjetër, me qëllim të mënjanimit sa më të shpejt të pasojave të ngjarjes së jashtëzakonshme.

Për ngritjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore të veta, hekurudha fqinje në marrëveshje me hekurudhën amë mundet t'i dërgoi punëtorët e vetë profesional dhe pajisjet e veta.

3. Nëse treni për çfarëdo shkaku do të qëndroi gjatë ndërmjet dy stacioneve kufitare, personeli i trenit duhet menjëherë ta informoi stacionin kufitar të hekurudhës në territorin e së cilës qëndron treni.

Stacioni kufitar i cili e ka pranuar informatën, është i detyruar që të kujdeset mbi përcjelljen e mëtejme të trenit. Nëse e vlerëson se është e nevojshme ndihma nga stacioni tjetër kufitar, mund ta kërkoj atë, e stacioni tjetër kufitar duhet të përgjigjet se a mundet ta siguroj ndihmën.

Stacioni kufitar është i detyruar që sapo të merr vesh për ngjarjen, menjëherë t'i informoj shërbimet kufitare.

4. Shkakun mbi ngjarjen e jashtëzakonshme dhe dëmet i cakton dhe i hulumton hekurudha në territorin e së cilës ka ndodhur ngjarja e jashtëzakonshme. Hetimi mbi shkaqet e ngjarjes së jashtëzakonshme në interes të dyja hekurudhave duhet të bëhet hollësisht. Rezultatet e hetimit, respektivisht informatat mbi rrjedhën e hetimit i dërgohen hekurudhës fqinje më së voni tri ditë pas ngjarjes së jashtëzakonshme. Nëse gjatë hetuesisë shtrohet pyetja mbi përgjegjësinë e hekurudhës fqinje ose mbi përgjegjësinë e përbashkët, hekurudha fqinje për atë menjëherë duhet të informohet, me caktimin e afatit të mjaftueshëm në të cilin do t'i dërgoi përfaqësuesit e vetë për arsye të hetimit të përbashkët të shkakut. Ky afat nuk mundet me qen më i gjatë se 48 orë, duke llogaritur nga pranimi i lajmërimit. Hetimin e mëtejmë e bënë komisioni i përzier hetues të cilin e

thirr dhe me të cilin kryeson hekurudha në territorin e së cilës ka ndodhur ngjarja e jashtëzakonshme. Në rast të mendimeve të pa pajtueshme në komision, pyetjet i zgjedhin shërbimet kompetente të dyja hekurudhave. Nëse në afatin e paraparë ose në afatin i cili më vonë dakordohet ndërmjet të dyja hekurudhave anëtarët e komisionit të hekurudhës fqinje nuk paraqiten, hetimin e bënë vetëm hekurudha amë. Në atë rast rezultati i hetimit është definitiv për të dyja palët.

5. Në rastet urgjente, hekurudha në territorit e së cilës ka ndodhur ngjarja e jashtëzakonshme mundet pa pëlqimin paraprak, t'i përdor mjetet lëvizëse hekurudhore dhe personelin e hekurudhës tjetër për dhënien e ndihmës në linjën hekurudhore kufitare ose në stacionin kufitar. Për këtë duhet menjëherë të informohet hekurudha tjetër.

6. Trenat ndihmës të hekurudhës fqinje i shoqërojnë personeli i hekurudhës amë deri në vendin e ngjarjes së jashtëzakonshme. Në rastet urgjente këta trena ndihmës munden me qen të zotëruar edhe me personel të hekurudhës fqinje me kusht që mirë ta njohin linjën hekurudhore, sinjalet dhe dispozitat e komunikacionit të hekurudhës amë. Udhëheqësi i trenit menjëherë me të arritur duhet të i lajmërohet personit i cili udhëheq me punët për shpëtim dhe spastrim dhe të punoi sipas udhëzimeve të tij.

7. Hekurudhat, nëse ajo është e mundshme duhen të ndihmohen ndërmjet veti me personel dhe material me kompensim të shpenzimeve.

Veprimi për procedimin e hetuesisë dhe caktimit të dëmit
Neni 28.

1. Komisioni i cili përbëhet nga numër i njëjtë i personave profesional të cilët i emërojnë të dyja hekurudhat e bënë hetuesinë për dëmin dhe caktimin e tij. Për deklaratat e personave të dëgjuar gjatë kohës së hetuesisë të cilën e kanë bërë çdo njëra hekurudhë për personelin e vetë, hartohet proces verbali në të cilin personat e dëgjuar me nënshkrim e vërtetojnë deklaratën e vet. Konstatimi i hetuesisë futet në procesverbal si konkluzion.

Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit dhe nga një ekzemplar e mbajnë të dyja hekurudhat.

2. Gjurmët dhe shenjat e dëmtimeve duhen të mbesin të pa ndryshuara deri në fillimin e punës së komisionit nga pika 1 për çka përkujdeset hekurudha në territorin e së cilës ka ndodhur dëmi.

Gjurmët dhe shenjat e dëmit mund të largohen vetëm aq sa është mjaft e mundur që të zhvillohet komunikacioni ose mbrojtja nga dëmtimi i mëtejmë.

3. Dëmet e parëndësishme i hetojnë së bashku shefat e stacioneve kufitare, (përfaqësuesit) ose njerëzit të cilët ata i autorizojnë, konstatimin e shënojnë në proces verbal të cilin reciprokisht e nënshkruajnë.

4. Për hetimin dhe caktimin e dëmit te dërgesat e mallrave, kafshëve të gjalla, vagonëve, makinerisë ngarkuese, paletave dhe kontejnerëve, zbatohen dispozitat ndërkombëtare përkatëse.

Përgjegjësia dhe kompensimi i dëmit
Neni 29.

1. Përgjegjësia për humbjen ose dëmtimin e dërgesave të mallrave, mjeteve lëvizëse hekurudhore, makinerisë ngarkuese, paletave dhe kontejnerëve, si dhe përgjegjësia mbi tejkalimin e afateve dërguese të dorëzimit, rregullohen me marrëveshje ndërkombëtare.

2. Nëse personi ka vdekur ose është lënduar, ose ndonjë gjësend është dëmtuar apo shkatërruar në stacionin kufitar hekurudhor, në stacionin e ndërrimit të komunikacionit ose në linjën hekurudhore kufitare, përgjegjëse janë:

- hekurudha, personeli i së cilës me faj të vetin e ka shkaktuar ngjarjen e tillë të jashtëzakonshme, nëse ajo nuk është caktuar ndryshe në dispozitat në vijim,
- hekurudha amë, nëse ngjarja e tillë e jashtëzakonshme ka ndodhur shkaku i parregullsive të linjës dhe pajisjeve hekurudhore, respektivisht të mjeteve lëvizëse hekurudhore të asaj hekurudhe,
- hekurudha e cila e fundit teknikisht i ka pranuar vagonët, nëse ngjarja e jashtëzakonshme është shkaktuar me pa aftësinë e tyre,
- hekurudha – pronare nëse ngjarja e jashtëzakonshme është shkaktuar nga pa aftësia e mjeteve lëvizëse hekurudhore të saj, e cila nuk ka mundur të caktohet me shikimin e paraparë teknik gjatë pranim dorëzimit.

Dëmshpërblimi për dëmtimin ose shkatërrimin e mjetit lëvizës hekurudhor nga hekurudha fqinje në territorin e hekurudhës amë, bien në barrë të hekurudhës amë, përveç në rastet nëse deri te dëmtimi ose shkatërrimi ka ardhur sipas fajësisë së personelit të mjetit tërheqës hekurudhor nga hekurudha fqinje.

3. Nëse deri te dëmi ka ardhur me fajin e personelit ose parregullsive në linjë dhe stabilimente të linjës hekurudhore ose mjeteve lëvizëse hekurudhore të dyja hekurudhave, hekurudhat janë përgjegjëse njësoj. Masa e njëjtë e ndarjes së përgjegjësisë vlen edhe në rastin kur nuk mundet të caktohet se cila hekurudhë është përgjegjëse. Nëse vjen deri te papajtueshmëria gjatë përcaktimit të përgjegjësisë, çdo njëra hekurudhë mundet të kërkoj vendim mbi arbitrazh në pajtueshmëri me dispozitat e Konventës për transportin ndërkombëtar hekurudhor – COTIF.

4. Dëmi në mjetet lëvizëse të cilat janë në pronësi të njërës nga hekurudhat fqinje dhe te i cili ka ardhur shkaku i forcës madhore, e mbulon ajo hekurudhë.

5. Shpenzimet për spastrimin dhe meremetimin në linjë dhe pajisje të linjës hekurudhore te të cilat ka ardhur shkaku i ngjarjes së jashtëzakonshme, i bartë hekurudha e cila është përgjegjëse për dëmin në pajtueshmëri me dispozitat paraprake. Këto dispozita aplikohen edhe në shpenzimet për hetuesi dhe veprime të cilat janë në lidhje me ngjarjen e cila e ka shkaktuar dëmin.

6. Nëse punëtori, i cili sipas kësaj marrëveshje e kryen shërbimin në stacionin kufitar, në stacionin e ndërrimit të komunikacionit ose në linjën hekurudhore kufitare, vdes ose lëndohet gjatë kryerjes së detyrës, ose ndonjë material zyrtare të cilin e ka me vete ose e transporton dëmtohet ose shkatërrohet, dëmin e mbulon hekurudha të cilës i përket punëtori, përjashtimisht nëse dëmi pjesërisht ose tërësisht e mbulon hekurudha e cila pjesërisht ose tërësisht është përgjegjëse.

7. Çdo njëra hekurudhë ka të drejt në kompensim nga hekurudha tjetër, nëse ajo është e detyrueshme në bazë të:

- Kësaj marrëveshjeje;
- Me vendim gjyqësor të plotfuqishëm, ose
- Me marrëveshje tjera ndërmjet të dy hekurudhave.

Ta bënë kompensimin e dëmit për të cilin është përgjegjëse hekurudha tjetër, dhe atë në tërësi ose pjesërisht.

8. Për kompensimet tjera dhe veprimet rreth tyre, kompetente janë marrëveshjet ndërkombëtare të cilat vlejnë për të dyja hekurudhat.

9. Në rastin e ngjarjes së jashtëzakonshme për të cilën janë përgjegjëse të dyja hekurudhat ose vetëm hekurudha fqinje, hekurudha amë mundet sipas marrëveshjes paraprake me hekurudhën fqinje, pa përsëritje të procedurës ta lejoj shpagimin e përkohshëm të dëmshpërblimit për palët e treta.

10. Hekurudha e cila pjesërisht ose tërësisht e ka paguar kompensimin për dëmin për të cilin përgjegjëse është hekurudha tjetër, ka të drejt të kërkoj nga ajo hekurudhë që të ia kompensoi dëmin e paguar.

11. Në rastin e kontesteve gjyqësore kur është fjala mbi kompensimin nga hekurudha tjetër, hekurudha – paditëse duhet me kohë ta informoj hekurudhën tjetër, duke i dhënë mundësinë asaj që para gjykatës t'i mbrojë interesat e veta.

Ofrimi dhe llogaritja e shërbimeve

Ofrimi i shërbimeve
Neni 30

1. Hekurudha amë në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, në kërkesë të hekurudhës fqinje me kompensim të shpenzimeve reale dhe në kufijtë e mundësive të veta i ofron shërbimet në vijim:

1.1 furnizimin e mjeteve tërheqëse me karburante, me vajra dhe materiale tjera me marrëveshje të posaçme ndërmjet hekurudhave;
1.2. Vendosjen dhe mbikëqyrjen e makinave dhe trenave motorik; dhe
1.3. Riparimin më të shpejt të makinave;

Shërbimet nën 1.1. dhe 1.3. duhen të vërtetohen me nënshkrimin e nëpunësve të dyja hekurudhave.

2. Në stacionet e ndërrimit të komunikacionit, hekurudha amë me kompensim të shpenzimeve ia siguron hekurudhës fqinje:

2.1. Lokale afariste, sipas marrëveshjes paraprake për nevoja e të gjitha shërbimeve të cilat marrin pjesë në kryerjen e shërbimit kufitar si dhe mirëmbajtjen, pastrimin, ndriçimin dhe ngrohjen e atyre lokaleve;
2.2. Hapësirën e nevojshme të deponimit;
2.3. Binarë e nevojshëm;
2.4. Vendosjen dhe tërheqjen e vagonëve nga binari nën pikën 2.3.;
2.5. Përmirësimin e ngarkesës, ngarkim- shkarkimin në rrugë e sipër dhe riparimin e vagonëve.

Për shërbimet nën pikën 2.4. dhe 2.5., duhet të lëshohet vërtetimi mbi shërbimin e kryer, të cilin e nënshkruajnë nëpunësit përgjegjës të dyja hekurudhave.

3. Hekurudha amë me kërkesë të hekurudhës fqinje ofron edhe shërbime tjera, përveç atyre të cituara në pikat 1 dhe 2, nëse ka mundësi për atë.

4. Shërbimet për tërheqjen dhe shoqërimin e trenave jepen sipas dispozitave të nenit 20 nga kjo marrëveshje.

Llogaritja e shërbimeve
Neni 31

1. Shërbimet për tërheqjen e trenave dhe shërbimet tjera në komunikacionin kufitar është e nevojshme të barazohet në mënyrë të natyrshme.

2. Hekurudhat borxhet e veta gjatë llogaritjes së shërbimeve dhe punës për të cilat nuk është i mundur barazimi reciprok i drejtpërdrejt natyral, barazohen në EUR, duke i pasur në konsideratë çmimet e kontraktuara në Shtojcën 1. të kësaj marrëveshjeje. Borxhet të cilat nuk barazohet në mënyrë të natyrshme rregullohen me llogari.

3. Trenat vetëm lokomotivë dhe të gjitha llojet e mjeteve lëvizëse hekurudhore (makinave, trenat motorik, drezinave të rënda motorike, makinave hekurudhore etj.), të cilat në territorin e hekurudhës fqinje transportohen me fletë ngarkesë, nuk merren në konsideratë gjatë llogaritjes natyrale të punës.

4. Shërbimet për tërheqjen e trenave, hekurudhat fqinje i caktojnë në bazë të evidencave të kontraktuara të cilat i udhëheqin stacionet e ndërrimit të komunikacionit dhe shërbimet tjera.

5. Këto evidenca duhen për çdo muaj të barazohen me hekurudhën fqinje.

6. Njësitë për llogaritjen e shërbimeve të ofruara janë:

6.1. Tërheqja e trenave:
- Për tërheqjen e trenave – sipas marrëveshjes së HK dhe MŽ
- për manovrim – sipas marrëveshjes së HK-MŽ

6.2. Për lokalet dhe binarët e dhënë në përdorim – sipas marrëveshjes së veçantë:
- për lokalet e dhëna në përdorim zyrtar (duke përfshirë pastrimin, ndriçimin dhe ngrohjen)- m² vjetor.
- për dhënien e hapësirës deponuese dhe rampës- m² vjetore.
- për shfrytëzimin e binarëve – për metër gjatësi vjetore

6.3. Për përmirësimin e ngarkesës dhe riparimin e vagonëve sipas shpenzimeve reale.

7. Përfaqësuesit e të dyja hekurudhave, në parim çdo gjashtëmujor i barazojnë shërbimet e ofruara në komunikacionin kufitar si dhe shërbimet tjera në stacionin e ndërrimit të komunikacionit.

8. Rezultati i barazimeve konstatohet me procesverbal në takimin e komisionit hekurudhor kufitar. Procesverbali do të jetë bazë për llogaritjen me atë rast, do të caktohet saldoja e efektit mbi tërheqjen e trenave dhe propozohen ndryshimi eventual i stacionit të ndërrimit të komunikacionit, respektivisht tërheqja e trenave, me qëllim të barazimit, në pajtueshmëri me pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

9. Për shërbimet e ofruara në stacionin e ndërrimit të komunikacionit, për çdo ditë, udhëhiqet evidenca në formulat të veçantë. Ai formular udhëhiqet në dy ekzemplar në bazë të vërtetimeve të lëshuara. Në fund të muajit, shefat e stacioneve kufitare, respektivisht të stacionit të ndërrimit të komunikacionit (dhe përfaqësuesit e hekurudhave) i harmonizojnë të dhënat e vëna dhe i eliminojnë dallimet e mundshme, e pastaj ia dërgojnë hekurudhës së vetë një ekzemplar të këtij formulari.

10. Formularët dhe vërtetimet, aplikimi i të cilave është rregulluar me këtë marrëveshje do të botohen në gjuhë punuese: shqip, maqedonisht, serbisht dhe anglisht. Formularët dhe vërtetimet secila hekurudhë i boton për nevojat e veta.

11. Llogaritja vjetore bëhet për çdo vjet për periudhën: 01. Janar deri më 31. Dhjetor.

12. Bazueshmëria e shpenzimeve si dhe e të gjitha kërkesave duhen të paraqiten ashtu që rrjedha dhe lartësia e tyre, të mund të verifikohen.

13. Nëse është e nevojshme, hekurudha e cila e paraqet kërkesën duhet që të njëjtës të ia bashkëngjit dokumentacionin përkatës.

14. Hekurudhat mund të bien në ujdi rreth shpenzimeve të parapara ashtu që njëra tjetrës gjatë vitit do t'i paguajnë paradhënie, nëse për atë vendoset në takimin e komisionit hekurudhor kufitar.

15. Kontrolli shtesë i llogaritjes vjetore mundet t'i bëhet në afat prej dy (2) viteve pas llogaritjes. Gabimet e mundshme pas kësaj mund të përmirësohen sa më parë që është e mundur.

Komisioni i përzier
Neni 32

1. Me qëllim të përmirësimit të komunikacionit hekurudhor kufitar dhe zgjidhjes së problemeve të cilët rezultojnë gjatë zbatimit të dispozitave nga Marrëveshja mbi rregullimin e komunikacionit hekurudhor kufitar dhe kësaj Marrëveshje, hekurudhat e të dy palëve do të formojnë komisionin e përzier.

2. Komisioni i përzier i analizon pyetjet rrjedhëse në lidhje me komunikacionin hekurudhor kufitar dhe në lidhje me zbatimin e "Marrëveshjes" dhe të kësaj Marrëveshjeje. Komisioni i përzier mundet me u propozuar palëve në Marrëveshje ndryshimet eventuale.

3. Propozimet mbi ndryshimin dhe plotësimin e "Marrëveshjes" dhe/ose kësaj marrëveshjeje, të cilat do t'i caktoj komisioni i përzier, futen në protokoll, e pastaj çdo njëra hekurudhë me arsyetimin e nevojshëm ia dërgon organeve kompetente hekurudhore dhe organeve kompetente të palëve të Marrëveshjes për shqyrtimin dhe zgjedhjen e mëtejme.

4. Komisioni i përzier takohet më së paku një herë në vit, në mënyrë alternative në territorin e njërës nga shtetet.

5. Hekurudha në territorin e së cilës thirret takimi i komisionit të përzier, e harton programin mbi punën dhe me kohë ia dërgon palës tjetër.

Data e takimit të komisionit të përzier caktohet në pajtueshmëri të dyja palëve.

6. Me komisionin e përzier kryeson ajo hekurudhë në territorin e së cilës mbahet takimi.

7. Protokolli i komisionit të përzier hartohet në njërën nga gjuhët punuese: (shqip, maqedonisht, serbisht dhe anglisht), dhe secila palë e mbanë nga një ekzemplar në gjuhën e vet.

8. Të gjitha vendimet komisioni i përzier i sjell në bazë të konsensusit.

Komisioni hekurudhor kufitar
Neni 33

1. Për funksionimin optimal dhe vendosjen nga fushëveprimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, hekurudhat e formojnë komisionin hekurudhor kufitar.

2. Komisioni hekurudhor kufitar i shqyrton të gjitha problemet dhe çështjet të cilat kanë të bëjnë me punën e shërbimeve hekurudhore në komunikacionin hekurudhor kufitar, verifikimin e ndërsjellët të llogaritjeve të shërbimeve dhe e cakton saldon përfundimtare të shpenzimeve.

3. Komisioni hekurudhor kufitar takohet më së paku dy herë në vit, në mënyrë alternative në territorin e njërës dhe tjetrës palë.

4. Hekurudha në territorin e së cilës thirret takimi i komisionit hekurudhor kufitar e harton programin e punës dhe me kohë ia dërgon hekurudhës tjetër. Datën e takimit e caktojnë në pajtueshmëri të dyja hekurudhat.

5. Me takimin e komisionit hekurudhor kufitar kryeson hekurudha në territorin e së cilës mbahet takimi.

6. Protokolli i komisionit hekurudhor kufitar hartohet në gjuhët punuese: (shqip, maqedonisht, serbisht dhe anglisht,) secila palë e mbanë nga një ekzemplar.

7. Numri i anëtarëve të çdo njërës hekurudhë caktohet posaçërisht për çdo takim të komisionit hekurudhor kufitar, në varësi nga rendi i ditës, problemeve dhe çështjeve të cilat do të shqyrtohen. Nëse është e nevojshme, në punë munden të kyçen edhe ekspert tjerë.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
Neni 34

Dallimet në interpretimin e dispozitave të kësaj marrëveshje si dhe i të gjitha çështjeve dhe problemeve nga fushëveprimi i rregullimit të komunikacionit hekurudhor kufitar, të dyja hekurudhat do t'i zgjidhin para se gjithash në suaza të komisionit të përzier dhe komisionit hekurudhor kufitar. Nëse ajo nuk është e mundur, mosmarrëveshjet do të zgjidhen te gjykata kompetente .

Dispozitat përfundimtare
Neni 35

1. Dispozitat e hollësishme mbi kryerjen e komunikacionit në kalimin kufitar do të rregullohen me dispozitat e përbashkëta zyrtare.

2. Komisioni hekurudhor kufitar e harton Shtojcën 1 në afat prej tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

3. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit me çka ndërpritet së zbatuari marrëveshja e përkohshme mbi rregullimin e komunikacionit hekurudhor kufitar ndërmjet Hekurudhave të UNMIK-ut (HU) dhe Hekurudhave Maqedonase (HM) nga 20.12.2005.

4. Të dyja hekurudhat e kanë lidhur këtë marrëveshje me atë që çdo njëra palë mundet me shkrim me e ndërpre. Marrëveshja pushon së zbatuari pas 6 muajve nga dita e anulimit, nëse hekurudhat nuk merren vesh ndryshe.

5. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje sillen në të njëjtën mënyrë sikurse edhe kjo marrëveshje.

6. Kjo Marrëveshje është hartuar në dy kopje prej çdo njërës gjuhë punuese dhe atë: 2 (dy) në gjuhën Shqipe, 2 (dy) Maqedonisht, 2 (dy) Serbisht dhe 2 (dy) në gjuhën Anglishte. Të gjitha tekstet janë autentike. Në rast të mospërputhjeve eventuale të teksteve në gjuhën Shqipe, Maqedonase dhe Serbe, atëherë mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Secila nga palët nënshkruese e marrin nga një ekzemplar të marrëveshjes në çdo njërën nga gjuhët punuese. .

Në Fushë Kosovë, me 15.02.2016

PËR INFRASTRUKTURËN E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS SHA – INFRAKOS

Kryeshefi Ekzekutiv - *Agron Thaqi*

PËR INFRASTRUKTURËN E HEKURUDHAVE MAQEDONASE JP MŽ INFRASTRUKTURA

Drejtori - *Irfan Asani*

PËR OPERIMIN ME TRENA TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS SHA – TRAINKOS

Kryeshefi Ekzekutiv - *Gelor Shala*

PËR TRANSPORTIN E HEKURUDHAVE MAQEDONASE MŽ TRANSPORT AD – SKOPJE

Drejtori Gjeneral- *Nikola Kostov*